

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“FREEWALK” SHPK**

Sot, më datë 29.04.2019, ortaku si më poshtë:

- 1. Z. Bruno Iaccarino**, shtetas italian, lindur më 17.11.1981 në Napoli (NA), dhe banues në Itali, në adresën: Rruga “Madonna Del Arco”, Nr. 339, Porto Sant’ Anastasia (NA) identifikuar me Pasaportën me Nr. YA9117816;

Vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

NENI 1  
DATA E THEMELIMIT

Sot, më datë 29.04.2019, themeluesi Z. Bruno Iaccarino vendosi të krijojë një shoqëri me emërtimin “FREEWALK” SHPK.

NENI 2  
FORMA E SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

NENI 3  
EMËRTIMI

Emri i plotë i shoqërisë është “FREEWALK” SHPK.

NENI 4  
SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga “Dritan Hoxha”, Pallati “Nord Construction”, pas Tirana Ring Center, Kati 5, Ap. 46, Njesia Administrative Nr. 7. Me miratim te organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 5  
KOHËZGJATJA



Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “FREEWALK” SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Blerjen, shitjen, tregtimin në tregun shqiptar dhe ndërkombëtar të mallrave, lëndës së parë dhe materialeve dhe aksesorëve për prodhimin e këpucëve. Tregtim, Import dhe eksport të mallrave të ndryshëm industrialë, ushqimorë etj.

Çdo aktivitet tjetër tregtar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10,000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortaku si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarrjes
<b>Bruno Iaccarino</b>	100 %	1	10,000 (lek)

Ky kapital është i ndarë në 1 (një) kuotë të zotëruar nga ortaku i vetëm.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

#### NENI 8 ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë “FREEWALK” SHPK do të jetë:

**Z. Bruno Iaccarino**, shtetas italian, lindur më 17.11.1981 në Napoli (NA), dhe banues në Itali, në adresën: Rruga “Madonna Del Arco”, Nr. 339, Porto Sant’ Anastasia (NA) identifikuar me Pasaportën me Nr. YA9117816.

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

#### NENI 9



## DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.  
Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.

Autorizohet Administratori z. Bruno Iaccarino si dhe çdo përfaqësues me prokurë i autorizuar prej tij, për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### THEMELUES:

Z. Bruno Iaccarino



Handwritten signature of Bruno Iaccarino in blue ink, consisting of a stylized 'B' and 'I' followed by the name 'Bruno Iaccarino'.